



**QENDRA  
KINEMATOGRAFIKE  
E KOSOVËS**

Ref. nr.	311/2021
Data	19.11.2021
Ne shkronja	
Potisi	D.B.
Signature	
Prishtinë, Prishtinë	

KD. Nr.01/2021  
Date: 19.11.2021

Në bazë të Ligjit për Kinematografinë Nr. 2004/22 nenit 29, Këshilli Drejtues në përbërje prej: Luan Daka, Anisa Ismaili, Alban Nimani, Besim Ugzmajli dhe Zethane Bahtiri –anëtarë, duke vepruar sipas propozimit të drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës nxjerr këtë:

**VENDIM**

Emërohen anëtarët e Jurisë Vlerësuese për projektet filmike të konkursit të vitit 2021 në kategorinë e filmit të metrazhit të shkurtë artistik, animacion, dokumentar, postproduksion, zhvillim skenari dhe të gjatë dokumentar.

Anëtarët e Jurisë Vlerësuese për kategoritë e lartecekura janë:

1. **Veton Nurkollari – Drejtor artistik në Doku Fest;**
2. **Lura Limani – Shkrimtare dhe kritike e kultures;**
3. **Besa Luci – Kryerdaktore e Kosovo 2.0;**
4. **Florent Mehmeti – Drejtor i Teatrit ODA;**
5. **Zgjim Terziqi – Regjisor;**
6. **Noar Sahiti – Regjisor dhe skenarist;**
7. **Vullnet Sanaja – Drejtor ekzekutiv i AniBar.**

Anëtarët e Jurisë Vlerësuese gjatë vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve janë të obliguar të zbatojnë Ligjin për Kinematografinë, Statutin e Qendrës Kinematografike të Kosovës, Rregulloren për punën e Jurisë Vlerësuese dhe Rregulloren për subvencionimin e projekteve filmike nga QKK. Juria Vlerësuese vlerësimet e veta në formë të shkruar ia paraqet QKK-së.

Anëtarët e Jurisë Vlerësuese në mbledhjen e parë e zgjedhin Kryesuesin e Jurisë Vlerësuese, i cili do të udhëheqë procedurat e vlerësimit të projekteve.

Për punën e kryer të gjithë anëtarët do të paguhen sipas honorarit të përcaktuar me Rregulloren nr. 08/2016 për punën e Jurisë Vlerësuese për projektet filmike që subvencionohen nga QKK.

**Vendimi i dërgohet:**

-anëtarëve të KD-së;

-arkivit të QKK-së.

-anëtarëve të përfshirë në këtë vendim

**Luan Daka**

Kryesues i mbledhjes së KD-së

